

**UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE**

**Fakulteti i Gjuhëve, kulturave dhe komunikimit**

**Studime pasdiplomike – Menaxhim dhe udhëheqje në arsim**



**Tema: “Roli i drejtorëve në sigurimin e cilësisë në shkollat e mesme të larta të komunës së Kamenicës”**

Mentor:

Prof. dr. Arafat Shabani

Kandidatja:

Nazlije Latifaj

## **Falënderime dhe mirënjohje**

*Këtë titull ia dedikoj prindërve të mi. Nënës sime në qiell dhe babit tim këtu që gjithnjë më ka përkrahur dhe këshilluar në jetë.*

*Një falënderim i veçantë shkon për Prof.As. dr. Arafat Shabani për orientimin dhe udhëheqjen profesionale të studimit i cili me vizionin dhe sugjerimet shkencore që më udhëhoqi gjatë gjithë punimit u bë motivuesi dhe mbështetësi kryesorë për ndërtimin e strukturës së studimit, thellimin e mendimit dhe sigurimin e informacionit të nevojshëm e konkret për temën, duke mundësuar realizimin me sukses të studimit. I jam shumë mirënjohëse për këmbënguljen e tij për të nxjerrë më të mirën prej meje si dhe për kontributin në drejtim të rritjes së nivelit argumentues mbi temën “Roli i drejtorëve në sigurimin e cilësisë në shkollat e mesme të larta të komunës së Kamenicës”.*

*Mirënjohje për udhëheqësit e shkollave, mësime dhe nxënësve të shkollave pjesëmarrëse në këtë hulumtim, të cilët lejuan që ta bëjë pyetëtorin me ta dhe intervistën dhe të marrë rezultate shumë të çmueshme lidhur me këtë problem.*

## **Abstrakti**

Ky hulumtim ka për qëllim për të identifikuar faktorët e rëndësishëm që ndikojnë në menaxhimin e shkollës dhe sigurimin e cilësisë në arsimin e mesëm të lartë në Kosovë si dhe me menaxherin dhe performancën e tij në menaxhim.

Duke standardizuar konceptet dhe dispozitat themelore - fushat e cilësisë, kriteret e cilësisë, treguesit e performancës, nivelet e vlerësimit dhe shkallët e cilësisë, Korniza për sigurim të cilësisë siguron koherencë dhe komplementaritet ndërmjet vlerësimit të brendshëm dhe atij të jashtëm të performancës së shkollës dhe ndërmjet niveleve të ndryshme të planifikimit zhvillimor të shkollës.

Në aspektin e cilësisë, nuk ka konsensus lidhur me atë se çka është arsim 'i mirë'. Cilësia kuptohet në aspektin e masave sasiore (inputeve) në vend se në drejtim të rezultateve. Kjo pikëpamje e ngushtë e cilësisë është një pengesë e madhe për të ndryshuar në mësimdhënie, nxënie dhe vlerësim në veçanti.

Ky hulumtim ka për qëllim të evidentojë rolin e drejtorit në sigurimin e cilësisë në shkollë. Po ashtu evidenton stilet e ndryshme të komunikimit që aktualisht përdorin udhëheqësit e shkollave fillore si dhe llojin e klimës që mbizotëron me palët e interesit për ngritjen e cilësisë.

Qëllimi i hulumtimit është të marrim të dhëna të sakta të cilat do të na mundësonin që të ndërmarrim hapa pozitive apo të bëjmë ndryshime në sistemin e arsimit në mënyrë që të ngritet roli i drejtorit në sigurimin e cilësisë në shkolla të mesme.

Për këtë hulumtim është përdorur qasja sasiore dhe cilësore, ndërsa modeli i zgjedhur është përshkrues. Të dhënat të cilat meren nga ky hulumtim do të jenë sasiore dhe do të përshkruajnë rolin e drejtorëve në sigurimin e cilësisë në shkolla të mesme të komunës së Kamenicës.

Hulumtimi u realizua në tri shkolla të mesme të komunës së Kamenicës në SH.M.L.P. "Andrea Durrsaku", SH.M.L.M. "Sejdi Kryeziu", SH.M.L. "Ismail Qemali". Në këtë hulumtim marrin pjesë 30 mësimdhënës dhe 60 nxënës me të cilët është realizuar pyetësori dhe 3 drejtor të shkollave me të cilët është realizuar intervista.

Fjalët kyçe: menaxhim, udhëheqje, sigurim, cilësi, drejtori, nxënësi, mësimdhënësi, shkolla, metoda.

## **Abstract**

This research aims to identify important factors that influence school management and quality assurance in higher education in Kosovo as well as for the manager and his performance in management.

By standardizing key concepts and provisions - quality areas, quality criteria, performance indicators, assessment levels and quality scales, the Quality Assurance Framework ensures coherence and complementarily between internal and external school performance evaluation and between different levels of school development planning.

In terms of quality, there is no consensus on what 'good' education is. Quality is understood in terms of quantitative measures (inputs) rather than in terms of results. This narrow view of quality is a major obstacle to change in teaching, learning and assessment in particular.

This research aims to identify the role of the principal in quality assurance at school. It also highlights the different communication styles currently used by elementary school leaders as well as the type of climate prevailing with quality-enhancing stakeholders.

The purpose of the research is to obtain accurate data that would enable us to take positive steps or make changes to the education system in order to enhance the role of the principal in quality assurance in secondary schools.

The quantitative and qualitative approach was used for this research, while the model selected is descriptive. The data obtained from this research will be quantitative and will describe the role of principals in quality assurance in secondary schools in the municipality of Kamenica.

The research was conducted in three high schools of the municipality of Kamenica in the High School of Kamenica. "Andrea Durrsaku", SH.L.M. " Sejdi Kryeziu ", SH.M. " Ismail Qemali". In this research 30 teachers and 60 students were interviewed and 3 principals were interviewed.

**Keywords:** management, leadership, assurance, quality, principal, student, teacher, school, method.

## Përmbajtja

I.	Abstrakt.....	3
II.	Abstract.....	4
III.	Përmbajtja.....	5
IV.	Lista e tabelave dhe grafikoneve.....	7
V.	Definimi i nocioneve themelore .....	8
	Hyrje.....	10
1.	<b>Shqyrtimi i literaturës.....</b>	11
1.1.	Procesi i zhvillimit të shkollës .....	11
1.2.	Roli i drejtorit në menaxhimin e shkollës.....	15
1.3.	Zhvillimi i shkollës dhe sigurimi i cilësisë.....	18
1.3.1.	Sigurimi i cilësisë në arsimin parauniversitar .....	19
1.4.	Personeli shkollor përgjegjës për koordinimin e cilësisë në shkollë .....	21
1.4.1.	Drejtori i shkollës .....	21
1.4.2.	Koordinatori i Cilësisë së Shkollës .....	23
1.5.	Roli i udhëheqjes arsimore në edukimin cilësor të shkollës.....	23
1.6.	Zhvillimi profesional i drejtorëve dhe mësimeve në ngritjen e cilësisë në shkollë..	27
1.7.	Komunikimi i drejtorit të shkollës me palët e interesit rritë cilësinë e shkollës.....	32
2.	<b>Metodologjia e hulumtimit.....</b>	34
2.1.	Qëllimi i hulumtimit .....	34
2.2.	Detyrat e hulumtimit .....	34
2.3.	Pyetjet e hulumtimit dhe hipoteza.....	34
2.4.	Grupi reprezentativ.....	35
2.5.	Metodat, instrumentet dhe procedura e hulumtimit .....	35
2.6.	Instrumenti i hulumtimit.....	35

2.7.	Rezultatet e pritshme të hulumtimit .....	35
<b>3.</b>	<b>Analiza e të dhënave dhe rezultatet .....</b>	<b>36</b>
3.1.	Rezultatet e hulumtimit nga pyetësi i realizuar me mësimdhënësit.....	36
3.2.	Rezultatet e hulumtimit nga pyetësi i realizuar me nxënës.....	46
3.3.	Rezultatet e marra nga intervista me drejtor .....	57
3.4.	Përpunimi i statistikave sipas programit Anova .....	61
3.4.1	Vërtetimi i hipotezave .....	61
4.	Përfundime .....	66
4.1.	Rekomandimet .....	68
	Literatura e përdorur.....	69
	Shtojca .....	74

## **Lista e tabelave dhe grafikonëve**

Tabela 1 – Statistikat përshkruese për hipotezën e parë

Tabela 2 – Korrelacioni për hipotezën e parë

Tabela 3 – Statistikat përshkruese për hipotezën e dytë

Tabela 4 – Korrelacioni për hipotezën e dytë

Tabela 5 – Statistikat përshkruese për hipotezën e tretë

Tabela 6 – Korrelacioni për hipotezën e tretë

## **Lista e grafikonëve**

Grafiku 1 – Të kënaqur me udhëheqjen dhe menaxhimin e shkollës

Grafiku 2 – Plotësimi i kushteve të shkollës për realizimin e procesit mësimor

Grafiku 3 – Drejtori përdor kritere për vlerësim të mësimdhënësve gjatë monitorimit

Grafiku 4 – Përzgjedhja e mësimdhënësve për trajnime të caktuara bëhet në mënyrë të drejtë nga stafi udhëheqës i shkollës.

Grafiku 5 – Zhvillimi profesional i drejtorëve dhe mësimdhënësve ndikon në cilësinë në shkollë

Grafiku 6 – Ndikimi i drejtorit tek mësimdhënësit dhe nxënësit në sigurimin e cilësisë

Grafiku 7 – Mësimdhënësit përdorin strategjitë e mësimdhënies që ndikojnë në sigurimin e cilësisë.

Grafiku 8 – Mësimdhënësit ballafaqohen me sfida/pasoja gjatë hartimit të planeve mësimore

Grafiku 9 – Mësimdhënësit përdorin kriteret e vlerësimit me nxënës.

Grafiku 10 – Krijimi i raporteve të mira të komunikimit të drejtorit të shkollës me palët e interesit rritë cilësinë e mësimin

Grafiku 11 – Nxënësit janë të kënaqur me udhëheqjen (menaxhimin) e shkollës

Grafiku 12- Shkolla i plotëson kushtet për realizimin e gjitha lëndëve.

Grafiku 13 - Nxënësit janë të kënaqur me raportin nxënës-mësimdhënës

Grafiku 14 - Raporti i nxënësve me punëtorët teknik është i kënaqur

Grafiku 15 - Raporti i mësimdhënësve me stafin e shkollës, pedagogun, psikologun

Grafiku 16 – Ndikimi i drejtorit tek mësimdhënësit dhe nxënësit në sigurimin e cilësisë

Grafiku 17 - Mësimdhënësit përdorin teknika të reja në mësimdhënie

Grafiku 18 - Mësimdhënësit janë bashkëpunues

Grafiku 19 - Nxënësit vlerësohen drejt nga mësimdhënësit

Grafiku 20 – Krijimi i raporteve të mira të komunikimit të drejtorit me palët e interesit

## **Definimi i nocioneve themelore**

PVSH – Plani Vjetor i Shkollës

PZHSH – Plani zhvillimor i shkollës

MASHT – Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë

DKA – Drejtoria Komunale e Arsimit

IZHA – Instituti i Zhvillimit të Arsimit

SMIA - Sistemi për menaxhim të informatave në arsim

Efektshmëria – Arritja e rezultateve të dëshiruara.

Efikasiteti – Arritja e rezultatit të dëshiruar duke përdorur sa më pak burime (si para, materiale, kohë, ekspertizë, etj.)

Arritshmëria – shkalla e përmbushjes së objektivave të caktuar, për shembull, objektivat shkollore, objektivat e projektit, objektivat e programit trajnues, objektivat mësimore, etj.

Instrumenti i vlerësimit – Mjetet që përdoren për të matur, vlerësuar dhe gjykuar për cilësinë e një rezultati të arritur.

Misioni – Deklarata e synimit që një institucion ka përgjegjësi të realizojë.

Modeli i drejtimit – Proces i organizuar që përdoret për të planifikuar përmirësimin e një shkolle (apo organizate tjetër). Ai nis me formulimin e vizionit nga ana e akterëve të shkollës, i cili përcakton çfarë dëshiron të arrijë shkollla brenda një periudhe të caktuar. Modeli i drejtimit bazohet në pyetje si: “Ku duam të arrijmë? Cilat vlera kanë rëndësi për ne? Çfarë ndryshimesh duhet të bëjmë në praktikën e mësimdhënies? Pse? Si mund ta bëjmë këtë? Si duam që nxënësit tanë të ndërveprojnë, mësojnë dhe bashkë-krijojnë? Thënë shkurt, modeli i drejtimit të shkollës është platformë udhëzuese drejt zhvillimit të shkollës.

Monitorimi – Procesi i krahasimit të vazhdueshëm të rezultateve të pritura me ato të arritura. Përdorimi i metodave sistematike për mbledhjen e të dhënave që masin përparimin drejt një synimi apo objektivi. (Synimi i monitorimit është të ndihmojë që puna në shkollë të jetë më e efektshme dhe e frytshme.)

Objektiva – Qëllimi për të arritur një rezultat konkret (zakonisht brenda një kohe të caktuar); synimet zakonisht përkufizohen nga objektivat konkrete për realizimin e tyre.



Pikësynimi – Arsytet pse bëhet diçka; zakonisht shprehet me synime apo rezultate.

Rezultati – Rrjedhoja a veprimeve të ndërmarra.

Standardet – Niveli i cilësisë së punës i dëshiruar apo pritur.

Synimi – Qëllimi për arritjen e rezultateve të dëshirueshme.

Vizioni – Deklarata që përshkruan gjendjen që dëshiron të arrijë shkolla; deklaratë që pasqyron synimet dhe besimet e përbashkëta dhe shërben për të orientuar veprimet e shkollës. Vizioni shërben si busull morale për sjelljen e personelit të shkollës dhe të Këshillit drejtues të shkollës.

Vlerësimi – Gjykimi rreth cilësisë dhe vlerës së rezultateve të arritura në krahasim me proceset e synuara; p.sh., matja e zotësisë së nxënësve apo vlerësimi i cilësisë së një procesi si mësimdhënia.

Zhvillimi i mësimdhënies – Procesi i organizuar për zhvillimin e njohurive dhe shkathtësive të mësimdhënësve përkitazi me procesin e mësimdhënies – të nxënësve, në përputhje me rezultatet që parasheh planprogrami për nxënësit, si dhe me hulumtimin e bërë në nivel ndërkombëtar rreth ‘praktikave më të mira’ të mësimdhënies.

## Hyrje

Mënyra si një udhëheqësi drejton shkollën, ka një rëndësi të veçantë në krijimin e një klime të përshtatshme për mësimdhënësit që të punojnë me përkushtim dhe për nxënësit që të jenë efektiv në të nxënë, kjo varet kryesisht nga komunikimi efektiv që bënë ai me palët e interesit. Drejtori në shkollë nuk duhet të jetë një person me titull të caktuar, por ai duhet të jetë një person që mban këtë titull me dinjitet. Për të qenë i tillë ai duhet të jetë një mësues, një organizator, njohës i mirë i problemeve të shkollës, përfaqësues i denjë edhe për komunitetin dhe mbi të gjitha ai duhet të jetë person me ndikim. Nuk mjaftojnë të gjitha këto nëse nuk është ai komunikues i mirë. Drejtori punën e tij duhet ta funksionojë në disa drejtime: të zbatoj politikat arsimore të instancave më të larta, të menaxhojë resurset materiale dhe njerëzore, të analizojë të arriturat individuale dhe të përgjithshme të shkollës, të planifikoj veprimtaritë dhe aktivitetet edukativo arsimore, të sfidojë punët e veta dhe të personelit të shkollës për arritjet dhe rezultate sa më të larta, të jetë shembull që reflekton energji pozitive dhe bashkëpunues me të tjerët.

Një veçori tjetër e vlerësimit të performancës së shkollës në Kosovë është karakteri zhvillimor i tij, duke shërbyer për planifikimin zhvillimor të shkollës dhe për monitorimin e zbatimit të tij nga vet shkolla. Prandaj, vetëvlerësimi në shkollë dhe planifikimi zhvillimor në shkollë janë dy anë të të njëjtit proces dhe përbëjnë një cikël të vlerësimit dhe intervenimit të planifikuar e sistematik që për qëllim përfundimtar kanë përmirësimin e cilësisë së shërbimeve shkollore, bashkëpunimin e komunikimin më të mirë me komunitetin dhe përfundimisht rritjen e kompetencave të nxënësve.

Menaxheri si një udhëheqës i institucionit shkollor ka një përgjegjësi mjaft të madhe ngase duhet të jetë një model i personalitetit të dalluar intelektual me gjitha përgjegjësitë që i ka mbi vete, si dhe të ketë aftësi për të krijuar cilësi organizative dhe kulturë menaxheriale. Udhëheqja është një ndër faktorët kryesor që ndikon në të nxënësit e nxënësit, përpos angazhimit prindëror dhe cilësisë së mësimdhënies.

Kurrikula e re siguron një nivel më të lartë të autonomisë shkollore për të planifikuar dhe realizuar zbatimin e saj në përputhje me kushtet specifike të personelit të saj mësimor, infrastrukturës shkollore dhe karakteristikave të tjera lokale ku vepron shkolla. Si e tillë, është përgjegjësi e drejtorit të shkollës për të siguruar që zbatimi i planit zhvillimor të shkollës dhe vlerësimi i performancës shkollore, të cilat janë të kërkuara me ligj, të zbatohen duke plotësuar pesë fushat e cilësisë sipas standardeve më të larta të mundshme në interesin më të mirë të nxënësve të tyre.

# 1. Shqyrtimi i literaturës

## 1.1. Procesi i zhvillimit të shkollës

*“Nuk mbijeton ai që është më i madhi, më i zgjuari apo më i miri; mbijeton ai që përshatatet më shpejt”.* Charles Darwin

Roli i ri dhe detyra thelbësore e çdo shkolle në Republikën e Kosovës është të sigurojë zotërimin e kompetencave kryesore të përcaktuara me kurrikulën shtetërore nga të gjithë nxënësit, në një mjedis të sigurt, përfshirës, miqësor dhe inkurajues për gjithë komunitetin shkollor. Korniza për sigurim të cilësisë së performancës së shkollës është ndërtuar mbi ndërveprimin në mes të (i) parimeve kryesore të Kornizës Kurrikulare të Arsimit Parauniversitar të Kosovës (KKAP) dhe (ii) fushave të cilësisë së performancës së shkollës.

Korniza parasheh pesë fusha të cilësisë së performancës së shkollës, të cilat shërbejnë si shtylla organizative për menaxhim të shkollës, vlerësim, vetëvlerësim, planifikim dhe intervenim përmirësues. Këto pesë fusha të cilësisë janë:

- 1) Menaxhimi dhe qeverisja,
- 2) Kultura dhe mjedisi shkollor,
- 3) Mësimdhënia dhe nxënia,
- 4) Zhvillimi profesional i mësimdhënësve, dhe
- 5) Performanca e nxënësve. ([https// korniza për sigurim të cilësisë nëntor, 2016](https://korniza.për.sigurim.të.cilësisë.nëntor,2016))

Udhëheqja është si arti dhe shkenca e “frymëzimit” dhe e realizimit të ëndërrave të përbashkëta. Drejtori është krijues, regjisor, aktor. (Sashkin, 2003)

Bilanci i llogaridhënies dhe përmirësimit është gjithashtu i rëndësishëm për cilësinë e brendshme sigurimit. Në nivelin e shkollës, ka disa dëshmi që mësuesi i fortë është mësues besim, një fokus kolektiv në përmirësimin e mësimdhënies dhe mësimin, dhe përvojën e mësuesve shoqërohen me nivele më të larta të arritjes së studentëve (Elmore, 2001). Nga ana tjetër, mësuesit në shkollat më të suksesshme kanë nivele më të larta besimi, gjë që tregon nivele të forta të kontrollit të brendshëm dhe llogaridhënies (O'Day, 2002). Cilësia e brendshme dhe mekanizmat e sigurimit janë më efektive kur mbështesin punën kolektive të mësuesve dhe janë të përqendruar në përmirësimin e mësimin.

Me decentralizimin e vazhdueshëm, përgjegjësitë kalohen nga niveli qendror në nivelin komunal dhe të shkollës. Zhvillimi i shkollës është një detyrë e çdo shkolle sot- e cila është një sfidë e madhe për shumë njerëz, por gjithashtu edhe një mundësi e madhe për t'u përfshirë!

Të jesh lider nuk do të thotë të jesh vetëm profesionist i përkryer në një fushë, por kjo do të thotë të jesh edhe lider në mënyrë si u drejtohesh të tjerëve, në komunikim dhe në sjellje. Udhëheqësit gjithmonë duhet t'i karakterizojnë sjellja udhëheqëse, që ka për qëllim të krijojë klimë të mirë në organizatën të cilën e udhëheq. (Haxhere & Shala, 2013)

Për udhëheqjen diskutohen mënyrat dhe stilet, ndërsa për drejtorin diskutohen aftësitë, cilësitë dhe kompetencat. Koncepti tradicional i udhëheqësit është imponimi i pajtueshmërisë, respektit dhe bashkëpunimit. (Adlam, 2003)

Udhëheqësi është person me stilin e vet, me pamjen, me karakteristikat dhe me sjelljen. Në teori, e sidomos në praktikën shkollore, janë të njohura shumë stile të udhëheqjes: stili autokratik, stili demokratik, stili liberal, stili likerit, stili bashkëpunues, stili i drejtuar drejt produktit, stili direktiv dhe stili mbështetës. Këto stile ndërmjet veti diferencohen me karakteristika të shumta. Pikënisjet për përcaktimin e stilit të udhëheqjes mund të jenë: cilësitë e udhëheqësit, raporti i tij ndaj bashkëpunëtorëve, shfrytëzimi i pozitës dhe i fuqisë që i është dhënë, raporti i tij ndaj detyrave që duhet t'i realizojë. (Bush , 2003)

Udhëheqësi është si një “portier i fuqishëm” pasi ai luan një rol të rëndësishëm në dhënien e vizionit të shkollës, arritjen e objektivave, promovimin e strukturave të punës bashkëpunuese, si dhe krijimin e ambienteve të përshtatshme për mësimdhënie. (Shailly, 2012)

Udhëheqësi konsiderohet si individi përgjegjës për standardin e krijuar në shkollën e tij. Për mënyrën e organizimit të aktiviteteve dhe veprimtarinë e shkollës, si institucion pedagogjik. Po ashtu përcakton dhe përmbush objektivat e shkollës, bazuar në vlerat e përgjithshme të saj. Ai thekson se udhëheqësi lidhet direkt me reformat e shkollës si dhe me promovimin e njohurive dhe qëndrimeve. (Fullan , 2008)

Mënyra në të cilën udhëheqësit e suksesshëm i zbatojnë këto praktika do të ndikohen nga një numër faktorësh, përfshirë gjykimin e tyre lidhur me kushtet e mësimdhënies dhe nxënies në shkollë, vetbesimin dhe përvojën e stafit të tyre, si dhe nivelet e sjelljes, aspiratave dhe arritjeve të nxënësve të cilat ndikojnë në një mjedis të dëshirueshëm për të gjithë ( Day, 1993) (Dey, 1993)

Kërkimet sugjerojnë që ka një lidhje të fortë mes cilësive personale të udhëheqësve dhe suksesit në drejtim, drejtorët janë komponentët kryesorë në sukses ( Leithwood, 1990 )

Prandaj është e domosdoshme që drejtori të zhvilloj stilin e udhëheqjes që mundëson rritjen e atmosferës në shkollë. Ku si rezultat, këto stile të udhëheqjes ndikojnë në rritjen e kënaqësisë së stafit në punë dhe në përgjithësi në krijimin e klimës në shkollë (Hoy dhe Miskrl, 2001).

Stili i udhëheqjes që udhëheqësit e një institucioni zgjedh të ushtrojë, mbështetet nga kultura dhe konteksti i atij institucioni, të cilat mund të ndikojnë në punën e mësimitdhënësve / dhe stafit të shkollës (Al-Omari, 2008). Shpeshherë drejtuesit pohojnë se pengesat në komunikim janë një nga problemet më serioze me të cilat ata ndeshen në praktikë. Pengesat e komunikimit në mjaft raste shërbejnë për të paralajmëruar ekzistencën e problemeve më të thella, prandaj një drejtues shkolle nuk duhet t'i marrë gjërat shumë sipërfaqësore, por duhet që ta trajtojë çështjen në mënyrë më të detajuar për të zbuluar shkaqet e vërteta të barrierave të komunikimit (Orhani , 2000).

Drejtuësit duhet t'i njohin mirë barrierat që pengojnë gjatë komunikimit: Mungesa dhe mangësitë e planifikimit, problemet semantike dhe gjuhësore, interpretimet e ndryshme të informacionit janë një pengesë tjetër kryesore në komunikim ku informacioni shpërndahet në individë të ndryshëm, shkalla e të dëgjuarit, informacionet e tepërta (Koxhaj & Tomini , 2003).

Teoria e Transformimit është një nga teoritë më të fundit të lidërshiptit. Kjo teori adreson mënyrën se si udhëheqësit i motivojnë dhe i frymëzojnë pasuesit e tyre për të arritur madhësinë . (Northouse, 2017) Ai përfshin udhëheqës që përshtaten me nevojat e atyre në sferën e tyre të ndikimit. Udhëheqësit transformues konsiderohen agjentë të ndryshimit të cilët kanë një vizion të qartë dhe largohen nga njohuritë e atyre në organizatë. Në këtë epokë të shek.21 përgjegjësia e drejtorëve është për të ushtruar forcë udhëheqëse mësimore në shkollat e tyre. Ata përballen me detyrën e rritjes së rezultateve të nxënësve duke ruajtur rendin përmes sjelljes së pranueshme të nxënësve që mund të kërkojë ndryshimi i klimës dhe kulturës së shkollës. (Tableman, 2004) Gjatë punës më të mirë të drejtorëve thekson Tableman (2004), llogaridhënia kryesore ndaj mësimitdhënies është kur lidërshipti lidhet me klimën e shkollës. Ajo deklaron se klima e shkollës është një element i rëndësishëm në diskutime rreth përmirësimit të arritjeve të nxënësve. Prandaj, klima e shkollës, llogaridhënia është gjithashtu një komponent shumë i rëndësishëm i udhëheqësit të shkollës. (Tableman, 2004)

Bazuar në faktorët e mësipërm, udhëheqësit transformues krijojnë besim përmes një marrëdhënie emocionale duke angazhuar punonjësit që të jenë plotësisht të angazhuar për

suksesin e shkollës, ata janë të pasionuar për atë që ata janë në gjendje të bëjnë dhe janë plotësisht të integruar në mbështetjen e misionit dhe vlerave të shkollës gjatë tërë kohës. Si udhëheqës ecin përpara në krijimin e kredibilitetit, ata tejkalojnë sfidën e ndërtimit të besimit midis individëve, grupeve, dhe organizimit përmes një procesi të krijimit dhe ruajtjes së një kulture në shkollë. (Dittmar, Jennings & Stahl-West, 2007)

" (Hoy, W. & Miskel, C., 2005, f. 185) e përcaktuan klimën e shkollës si" grup të brendshëm karakteristikat që dallojnë një shkollë nga një tjetër dhe ndikojnë në sjelljet e secilit anëtarë të shkollës ".

Udhëheqësit më të suksesshëm të shkollës janë fleksibil dhe jo dogmatik të cilët duke menduar brenda një sistemi të vlerave thelbësore duke përfshirë qëndrueshmërinë, elasticitetin dhe optimizmin, tipare të tilla ndihmojnë të shpjegojnë pse liderët e suksesshëm përballen me kushtet e frikshme shpesh në gjendje të shtyjnë proceset përpara kur ka pak arsye të presim progres. (Day, Sammons, Leithwood, Hopkins, Harris & Brown, 2010)

Prandaj, studiuesit rekomandojnë praktikën e këtyre udhëheqësve të cilët janë gjetur të kenë një ndikim të rëndësishëm në anëtarët e mësimdhënësve / pedagogëve kënaqësinë e punës në atë kontekst të veçantë me qëllim të rritjes së efektivitetit institucional (Nguni , Slegers, and Denessen, 2006)

Maslin-Ostrowski (2002) shpjegon, "Kushtet e terrenit duke përfshirë mënyrën e kohës, hapësirën dhe modelet e komunikimit janë të strukturuar - janë pjesë përbërëse e botës së çrregullt të shkollës lidhshme. Administratori pothuajse nuk ka kohë për të reflektuar ose për të folur me kolegë të besueshëm për shqetësimet dhe frikën, një udhëheqës lehtë mund të jetë i izoluar dhe është shumë vështirë të mbajnë barrën e udhëheqjes vetëm. (Ackerman, R., & Maslin-Ostrowski, P., 2002, f. 11)

## **1.2. Roli i drejtorit në menaxhimin e shkollës**

Arritjet më të mira të mundshme në të gjitha punët në shkollë varen nga “veprimet drejtuese” të udhëheqësit të institucionit, që domosdoshmërisht lidhen me vendimmarrjen, planifikimin, organizimin, bashkërendimin dhe procese të tjera përcjellëse, si motivimi dhe kontrolli.

Prandaj, krijimi i një mendimi pozitiv në shkollë, i një klime të mirëkuptimit dhe respektit të ndërsjellët të stafit të shkollës me nxënës dhe prindër, duke u ofruar mundësi të barabarta të gjithëve për suksese në mësimdhënie dhe në mësimnxënie, tregon për një vizion të drejtorit të shkollës, i cili është garanci edhe për rezultate të shënuara në këtë fushë. Në literaturën e kësaj fushe gjejmë edhe përdorimin e nocioneve tjera për udhëheqjen e shkollës, si shprehjen “qeverisje e shkollës”, (Backam E.&Trafford B., 2007, f. 38) e cila nënkupton një udhëheqje demokratike, e bazuar në vlerat e të drejtave të njeriut, autorizimin, gjithëpërfshirjen, etj.

Përkufizimi i udhëheqjes nxjerr në pah këto pika: ka të bëjë me drejtimin dhe ndikimin. Stabiliteti është qëllimi i asaj që shpesh quhet menaxhim. Përmirësimi është qëllimi i lidershit. Por të dyja janë shumë të rëndësishme. Një nga kërcënimet më serioze ndaj stabilitetit në një distrikti shkollor është qarkullim i shpeshtë në radhët e superintendentëve, drejtorëve dhe zëvendës drejtorët. Paqëndrueshmëria në nivelin e shkollës shpesh pasqyron një dështim të menaxhimit në nivelin e qarkut.

Një kërkesë thelbësore, që shtrohet para një subjekti menaxherial, është aftësia për të bërë ndryshime. (Fullan M., 2002) Kur dihet se procesi i ndryshimit nuk zhvillohet lehtë e as pa sakrifica të shumta, ai kërkon, jo vetëm udhëheqës kurioz e të guximshëm, ballafaqim me sfida të shumta, por, para së gjithash, dije, vizion dhe planifikim të rrugëve dhe etapave të zhvillimit të një procesi drejt ndryshimit.

Menaxhimi i procesit të zhvillimit të kurrikulimit qëndron në thelbin e një drejtori të udhëheqjes pedagogjike. Nëse drejtori nuk e udhëheq procesin, do të udhëhiqet nga dikush tjetër, që do të thotë që drejtori heq dorë nga ndoshta më i rëndësishmi mjet pedagogjik udhëheqës. Që nga menaxhimi i procesit të zhvillimit të kurrikulimit nuk mund të jetë thjesht menaxhim teknik, por është gjithashtu e drejtë të thuhet se ka nevojë për një drejtues të shkollës të jetë një pedagog solid me kualifikime të mësimdhënies. Të jesh një menaxher profesional nuk është mjaftueshëm për menaxhimin e suksesshëm të shkollës.

Disa studime ndërkombëtare (p.sh. (Barth, R. S. , 2006, f. 8) dhe (Sergiovanni, T. J., 2005, f. 112) kanë treguar se kultura organizative e shkollës ka një ndikim thelbësor në ecurinë e shkollës dhe rezultatet e mësimin.

Ndryshimin duhet kuptuar vetëm si një mundësi më e mirë dhe me efekte pozitive nga të gjithë. “Secili i punësuar duhet ta kuptojë ndryshimin, si mundësi që në proces e sipër secili në kohë të ndryshme do të fitojë optimumin nga mënyra e re e bërjes së punës”. (Zeneli I, 2013) Pra, pa punën e drejtorit, pa nismat e tij, pa angazhimin në nisma konkrete

dhe pa një koordinim të mirë të të gjitha resurseve në shkollë nuk mund të priten rezultate të dallueshme e as ndryshime të gjendjes që do të reflektonin përparim menaxherial dhe menaxhim të suksesshëm të institucionit konkret.

Komunikimi dhe bashkëpunimi kanë një rol shumë të rëndësishëm në marrëdhëniet në mes të menaxherit dhe të akterëve të tjerë të involvuar (përfshirë) për zhvillimin e procesit mësimor efektiv dhe bashkëkohorë. „Drejtori i shkollës e udhëheq shkollën të bëhet shkollë e mirë, shkollë cilësore, përmes:

- ✚ Përdorimit të shkathtësive efektive komunikuese personale;
- ✚ Vendosijes së një sistemi formal të komunikimit (apo një strukture komunikuese) që i informon prindërit, komunitetin dhe të tjerët lidhur me jetën e rëndësishme të shkollës;
- ✚ Sigurimit se shkolla është mirëpritëse dhe miqësore dhe di si t'i dëgjojë nevojat, shqetësimet dhe dëshirat e palëve të saj;
- ✚ Ndërtimit të marrëdhënieve personale e institucionale brenda shkollës dhe mes shkollave, komunitetit dhe aktorëve të tjerë që nxisin bashkëpunimin dhe mbështesin arritjen e suksesit të shkollës;
- ✚ Sigurimit që komunikimi dhe marrëdhëniet përkrahen nga menaxhimi efektiv i kohës, dokumenteve dhe takimeve”.

Organizimi dhe marrëdhëniet e stafit të shkollës do të jenë pozitive kur të gjitha mendimet dhe sugjerimet janë dëgjuar dhe me kusht që kërkesat e tyre të analizohen dhe të aprovohen nga këshilli i shkollës dhe drejtori. " Fuqia e menaxherit të njohurive të tij matet, kur krahasohet me përpjekjet tjera për të bërë ndryshime pozitive në shkollë, i cili përqendrohet te mësimdhënësit e shkollës, stafin dhe nxënësit - për të punuar lidhur me nevojat e tyre ". (Lisa A. Petrides and Thad R. Nodine, 2003)

Një udhëheqës, një menaxher i suksesshëm duhet të ketë personalitet të ekuilibruar, stabil dhe të përmbajtur, i cili, krahas vlerave tjera profesionale, e ndërton imazhin e një drejtori të suksesshëm, bashkëpunues dhe tolerant, pra me sjellje të kontrolluara. Prandaj, “personaliteti mund të përkufizohet si një pako dinamike e tipareve mendore, shpirtërore dhe fizike, të cilat përcaktojnë sjelljet e një njeriu në një mjedis të caktuar”. (Zeneli I, 2013, f. 230)

Menaxhimi është: - një përpjekje për të planifikuar, organizuar dhe udhëhequr njerëzit dhe resurset për një qëllim të caktuar me një rezultat të caktuar - proces i ndërmarrë që të koordinojë veprimet e të tjerëve në mënyrë që të arrijë rezultatet e përcaktuara - proces i cili



identifikon, organizon dhe rendit të gjitha detyrat, teknikat, resurset dhe metodat për të arritur rezultatet e përcaktuara të projektit. Një përshkrim i thjeshtësuar i menaxhimit të projektit nga një grup autorësh është: “menaxhimi i projektit është vetëm një mjet, një listë e metodave dhe teknikave që na ndihmon të arrijmë qëllimet dhe objektivat tona. (Grup autoresh, 2002, f. 21)

Një nga tiparet e lidërshiptit është të udhëheqë stafin e shkollës në tërësi përmes rekomandimeve. Udhëheqësi i përsosur nuk imponon urdhëra të ashpra ndaj stafit, por u jep atyre udhëzime dhe këshilla dhe mësimdhënësit dhe stafi ndihen të mirëseardhur në bashkëpunim. Ashtu si kjo, drejtori efektiv jep udhëzime dhe udhëzime për tërë stafin e shkollës dhe i fton ata për të marrë pjesë në zhvillimin e arsimit sipas programit të paraparë. Drejtorët sot duhet të jenë udhëheqës udhëzuesë të aftë për të duke zhvilluar një ekip mësuesish të cilët japin udhëzime efektive për secilin nxënës "(Fondacioni Wallace, 2013, f. 6). "Parimet luajnë një rol të madh në zhvillimin e një "profesionalizmi të mësimdhënësit" duke i udhëzuar ata që të bëjnë ndryshime pozitive dhe të ndikojnë në përmirësimin e mësimin ". (The Wallace Foundation, 2013, f. 6)

Kur krahasojmë qasje të ndryshme të lidërshiptit që mund të ofrojë një drejtor, disa nga studiuesit gjetën se "udhëheqja mësimore" ka tre deri në katër herë më shumë ndikim në arritjet e nxënësve se "Udhëheqja transformuese", ku drejtorët përqëndrohet në motivimin dhe përmirësimin e moralit të mësuesit e tyre. (Robinson, V. M. J., Lloyd, C. A., & Rowe, K. J., 2008, fv. 635–674)

Drejtori i shkollës së sotme duhet të jetë një lider i kualifikuar që e kupton zhvillimin e arsimit dhe ka aftësi solide të menaxhimit për të udhëhequr një shkollë.

(Aho, E., Pitkänen, K. & Sahlberg, P., 2006, f. 119) e përmbledhin ndryshimin si më poshtë: “Roli i drejtorëve të shkollave gjithashtu ka ndryshuar në mënyrë dramatike që nga viti 1990. Drejtorët nuk janë vetëm udhëheqësit arsimorë të shkollave të tyre, por edhe menaxherët që janë përgjegjës për financimin, personelin dhe rezultatet e institucioneve të tyre.

### **1.3. Zhvillimi i shkollës dhe sigurimi i cilësisë**

Zhvillimi i shkollës është një proces që duhet të organizohet në secilën shkollë dhe përfshin akterë të ndryshëm, si mësimdhënësit, prindërit dhe nxënësit. Prandaj, është e nevojshme të zhvillohen takime me të gjitha palët e interesuara për të diskutuar dhe marrë idetë e tyre për përmirësimin e shkollës. Shkollat moderne nuk mund të udhëhiqen si sistemi i

“mbyllur”, por duhet të marrin parasysh dhe t’i përfshijnë të gjithë akterët brenda dhe jashtë shkollës.


Prandaj është e domosdoshme që drejtori të zhvilloj stilin e udhëheqjes që mundëson rritjen e atmosferës në shkollë. Ku si rezultat, këto stile të udhëheqjes ndikojnë në rritjen e kënaqësisë së stafit në punë dhe në përgjithësi në krijimin e klimës në shkollë (Hoy, W. K. & Miskel, C. G., 2001, f. 38).


Mjedisi i shkollës nuk është i njëjtë për të gjithë nxënësit. Për disa nxënës shkolla mund të jetë mike. Për disa mund të jetë një mjedis i ftohët. Për qëndrimet dhe ndjenjat tona që vijnë nga një mjedis shkollor i referohen klimës së shkollës. Vështirë mund të japim një përkufizim përmbledhës për klimën e shkollës sepse këtu përfshihen këto dimensione ai fizik, social dhe akademik. (Bolman, L. G. & Deal, T. E., 2010)

Zhvillimi i shkollës nuk duhet parë si diçka krejtësisht e ndarë nga aktivitetet e përditshme të shkollës, por si një proces dinamik i ndryshimeve për të mirën e arritjes së mësimdhënies dhe nxënies më të mirë, dhe një profili tërheqës të shkollës. Ky proces nuk mund të zhvillohet pa pjesëmarrjen e gjithë akterëve, për të harmonizuar planifikimin dhe hapat sistematik. Vetëm me pjesëmarrjen e grupeve si mësimdhënësit, nxënësit, prindërit dhe komuniteti i gjerë, shkolla mund të zhvillojë plotësisht potencialin e saj dhe të arrijë rezultatet më të mira të mundshme.

Zhvillimi i shkollës është më shumë se një proces menaxhimi. Para se një menaxhim i tillë të mund të fillojë, ekziston nevoja për krijimin e një pasqyre të përbashkët rreth filozofisë, çka do të thotë një pasqyrë rreth vlerave normative në sjellje ndërmjet mësimdhënësve dhe nxënësve, mësimdhënësve dhe mësimdhënësve etj. Është themel i çdo komunikimi ndërmjet akterëve të ndryshëm të shkollës, por gjithashtu themel i çdo veprimtarie.

Zhvillimi i shkollës nënkupton procesin e vazhdueshëm të përmirësimit, duke ndjekur një sërë hapash që mund të përshkruhen duke përdorur ciklin Planifiko- Bëj- Kontrolllo- Vepro (PBKV), për të siguruar cilësinë në shkollë. (Ngritja e Kapaciteteve në Udhëheqjen Arsimore, 2017:10)





**Figura 1: Procesi i sigurimit të cilësisë**

### **1.3.1. Sigurimi i Cilësisë në arsimin parauniversitar**

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Kosovës ka miratuar Strategjinë e Sigurimit të Cilësisë për Arsimin Parauniversitar të Kosovës për vitet 2016-2020, me qëllim që të kontribuojë në përmirësimin e shërbimeve arsimore dhe rezultatet e arsimit. <https://masht.rks-gov.net/uploads/2016/12/qa-strategy-final-english.pdf>

Kjo strategji ka katër komponentë të ndryshëm, të përfaqësuar nëpërmjet objektivave strategjike dhe masave që ndërlidhen me:

**Objektivi 1:** Ndërtimi i mekanizmave efektiv për sigurimin e cilësisë

- Ndërtimi i një sistemi efikas për vlerësimin e shkollës;
- Zbatimi i ciklit të menaxhimit të cilësisë në arsim;
- Fuqizimi i organeve shkollore për të kryer funksionin e tyre të sigurimit të cilësisë;
- Përcaktimi i rolit të DKA-ve në sigurimin e cilësisë dhe ndërtimin e strukturave përkatëse për sigurimin e cilësisë në DKA-të;
- Funksionimi i Inspektoriatit në aspektin ligjor- administrativ dhe pedagogjik-profesional;
- Funksionalizimi i sistemit të licencimit të mësimdhënësve;

- Shfrytëzimi efektiv i të dhënave mbi monitorimin e arsimit për sigurimin e cilësisë në të gjitha nivelet;

**Objektivi 2:** Avancimi i planifikimit të zhvillimit në nivel të shkollës dhe komunës

- Rishikimi i procedurave dhe instrumenteve për planifikimin e zhvillimit;
- Monitorimi i zbatimit të planit zhvillimor të shkollës;
- Harmonizimi i planeve komunale me planet shkollë sipas fushave të cilësisë;

**Objektivi 3:** Ndërtimi i kapaciteteve për sigurimin e cilësisë në të gjitha nivelet

- Ngritja e kapaciteteve të inspektimit për përgjegjësitë e reja;
- Hartimi i Doracakut për grupet profesionale të shkollave me fokus në zhvillimin e cilësisë;
- Trajnimi i stafit të DKA-ve, drejtorëve dhe personelit përgjegjës të shkollës për menaxhimin e cilësisë;
- Sigurimi ndihmës nga grupet profesionale në nivel komunal;
- Trajnimi i përfaqësuesve të shkollave dhe komunave për planifikimin e zhvillimit;
- Zbatimi i sistemit të monitorimit për mësimdhënësit e ri në shkolla;

**Objektivi 4:** Rritja e vetëdijes së akterëve rreth sigurimit të cilësisë.

- Publikimi i rezultateve të testeve kombëtare dhe ndërkombëtare;
- Promovimi i suksesit dhe shpërblimi i arritjeve;
- Informimi i prindërve mbi aspekte të ndryshme të kurrikulës dhe sigurimit të cilësisë;
- Promovimi i debateve publike me cilësinë në arsim;
- Krijimi i portalit për sigurimin e cilësisë;

MASHT-i, me mbështetjen e akterëve dhe partnerëve ka filluar të hartojë masat e parapara në këtë strategji. Disa nga masat tashmë janë hartuar dhe pilotuar, dhe shkollat po fillojnë t'i zbatojnë ato, siç janë Korniza e Vetëvlerësimit të Performancës së Shkollës, Plani Zhvillimor i Arsimit në Komunë, Plani Zhvillimor i Shkollës, emërimi i koordinatorëve komunal të cilësisë në arsim, koordinatorët e cilësisë me bazë në shkollë etj. ( MASHT, 2017)

#### **1.4. Personeli shkollor përgjegjës për koordinimin e cilësisë në shkollë**

Në mënyrë që plani i zhvillimit të cilësisë së shkollës të zbatohet më sukses, këta janë njerëzit përgjegjës brenda shkollës:

- ✓ Drejtori i shkollës

- ✓ Koordinator i cilësisë
- ✓ Mekanizmi për vlerësimin e shkollës
- ✓ Aktivitetet profesionale

### 1.4.1. Drejtori i shkollës

Drejtori i shkollës është personi kyç për të lëvizur më tej proceset në shkollë, si dhe për të motivuar dhe angazhuar komunitetin e shkollës. Drejtori i shkollës duhet të udhëheqë të gjithë procesin e përgatitjes së Planit Zhvillimor të Shkollës. Për më tepër drejtorët e shkollave janë gjithashtu përgjegjës për hartimin e Planit Vjetor të Punës për shkollat e tyre dhe gjithashtu për Planin Personal të Punës siç kërkohet nga DKA-ja.

Gjatë viteve të kaluara, MASHT-i në bashkëpunim me donatorët, sidomos me USAID-in, BE-në dhe GIZ-in kanë përkrahur procesin e zhvillimit të kapaciteteve të edukatorëve për menaxhimin dhe udhëheqjen e shkollave. Një dokument kyç që përcakton standardet e performancës për drejtorët e shkollave është miratuar si UA në vitin 2012, përkatësisht UA nr.04/2012. Ky dokument përcakton gjashtë standarde të performancës që udhëzojnë drejtorët e shkollave në kryerjen e detyrave të tyre. Për qëllimet e Planit Zhvillimor të Shkollës, drejtorët e shkollave duhet t'u referohen standardeve të mëposhtme:

**UA 04/2012: Standardet e drejtorëve të shkollave që ndërlidhen me përgjegjësitë lidhur me planifikimin e zhvillimit të shkollës dhe menaxhimin e projekteve.**

<b>Standardi 1:</b>	<b>Standardi 3:</b>	<b>Standardi 4:</b>
<p><b>Udhëheqja dhe Motivimi</b></p> <p>-Vlerësimi i efektivitetit të shkollës- Strategjisë së Sigurimit të Cilësisë; Monitorimi dhe vlerësimi i efikasitetit të shkollës;</p> <p>- Planet Zhvillimore të shkollës- Fazat e Zhvillimit të Shkollës;</p> <p>- Përgatitja për PZhSh-në;</p>	<p><b>Planifikimi dhe Menaxhimi</b></p> <p>-Planet zhvillimore të shkollës- Fazat e Zhvillimit të shkollës;</p> <p>- Përgatitja për PZhSh-në;</p> <p>- Zbatimi i PZhSh-së;</p> <p>- Vendi i Këshillit Drejtues të shkollës;</p>	<p><b>Bashkëpunimi dhe Ndërveprimi</b></p> <p>-Vendi i Këshillit Drejtues të Shkollës;</p> <p>- Rolet dhe përgjegjësitë e shkollës për të bashkëpunuar me komunitetin e shkollës;</p>

- Zbatimi i PZhSh-së.		
-----------------------	--	--

### **Roli i drejtorit të shkollës:**

Me rritjen e autonomisë, drejtorët e shkollave duhet të bëhen vizionar, planifikues arsimor, iniciatorë të zhvillimit shkollor, komunikues për të siguruar pjesëmarrjen e gjerë të komunitetit, përkrahës të cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie, moderatorët për akterët kyç të shkollës, menaxher për burime teknike dhe financiare, liderë për personelin dhe nxënësit e tyre të cilët marrin vendime të informuara mbi bazën e të dhënave dhe drejtojnë shkollën e tyre në mënyrë efikase dhe strategjike në një kontekst gjithnjë e më konkurrues në mënyrë që të arrijnë rezultatet më të mira të mundshme për nxënësit e tyre me burimet në dispozicion.

Në këtë rast kur jemi tek roli i drejtorit i përmendim disa prej tipareve kryesore që i posedon ai:

- Sigurimi i një mjedisi miqësor ndaj nxënësve, të sigurt, të këndshëm dhe të përshtatshëm për mësim.
- Përfshirja e akterëve dhe partnerëve të arsimit në vendimet e shkollës.
- Sigurimi i të mësuarit dhe zgjedhjes së diferencuar në kontekstin e aktiviteteve kurrikulare dhe jashtëkurrikulare.
- Sigurimi i qëndrueshëm në të gjithë shkollën në nxitjen e mësimdhënies me nxënësin në qendër.
- Mbështetja e trajnimit dhe mentorimit të mësimdhënësve të bazuar në shkollë si një mjet për të përmirësuar aftësitë mësimore të personelit.
- I kushton vëmendje të veçantë zbatimit të parimeve dhe praktikave të arsimit gjithëpërfshirës.
- Në bashkëpunim me të tjerët punon drejt zhvillimit të një projekti të qartë.

- I ndihmon shkollave që të bëhen organizata mësimore dhe ‘magnet’ për komunitetin nëpërmjet krijimit të komuniteteve të praktikës; programeve të shkrim-leximit dhe për mësimin e të rriturve. (MASHT, 2017:24)

#### **1.4.2. Koordinator i Cilësisë së Shkollës**

Koordinatori i Cilësisë së Shkollës është personi kryesor në shkollë për të udhëhequr proceset e sigurimit të cilësisë në shkollë. Sa i përket PZhSh-së, ai duhet të mbështesë procesin e vetëvlerësimit të performancës së shkollës dhe të punojë ngushtë me drejtorin e shkollës në koordinimin e aktiviteteve të ndërlydhura me PZhSh-në. Gjithashtu, KCS është përgjegjës për të përgatitur raportin e detajuar për aktivitetet e koordinimit të cilësisë në shkollë, i cili shërben si pikë fillestare për planin vjetor të shkollës dhe planin zhvillimor të shkollës. Rolet dhe përgjegjësitë e veçanta të KCS-së rregullohen me UA nr.23/2016. (MASHT, 2017:22)

#### **1.5. Roli udhëheqjes arsimore në edukimin cilësor të shkollës**

Njëra ndër bisedat që diskutohen lidhur me cilësinë arsimore në edukim padyshim është edukimi cilësor në shkolla. Çka është cilësia arsimore, si përkufizohet ajo, si kuptohet dhe trajtohet nga përfaqësuesit e arsimit, si arrihet, si vlerësohet dhe si matet, janë pyetje, të cilat i orientojnë diskutimet e shumta në nivele të ndryshme të arsimit, duke filluar nga niveli shkollor komunal e deri në nivel qendror dhe anasjelltas. Krahas diskutimeve të shumta për çështje të cilësisë arsimore, krahas përcaktimit të standardeve dhe kritereve të cilësisë dhe krahas vendosjes së kritereve për ta matur cilësinë, po ashtu, diskutohet edhe për rolin e udhëheqjes së shkollës dhe rolin e drejtorit të shkollës në zhvillimin, zbatimin dhe avancimin e të gjithë mekanizmave me bazë në shkollë për implementimin e politikave arsimore që janë në funksion të cilësisë.

Shkollat e shekullit 21 zhvillojnë liderë për të ardhshmen "nga përmirësimi në transformim". Udhëheqja nuk do të ndryshojë nëse qasja jonë do të jetë e rastësishme dhe e paqëndrueshme; ne kemi nevojë për një plan, qasje graduale dhe kohezive të drejtuesve të shkollave të të sotmes dhe të nesërmes, të cilët kanë njohuri profesionale, shkathtësi për të arritur sukses. (West-Burnham, J., 2009, f. 101)

Nga rrethi vicioz mund të dilet vetëm me planifikim bashkëkohor të ndryshimeve e sidomos në fuqizimin e partneritetit shkollë-komunitet. Partneriteti me fytyrë njerëzore është shumë i rëndësishëm andaj hapin e parë duhet ta bëjë shkolla. Nismat mund edhe të pengohen (legjislacioni, rezistuesit etj..), por shkolla nuk guxon të dekurajohet. Funkcionalizimi i fuqisë

